

RAPORT I AKTIVITETEVE TË KAMPIT
PERSONAT ME LËNDIME SPINALE
ULQINI 2009
GR. -II-
21.08.2009-01.09.2009

Në këtë kamp marrën pjesë gjithsejt 50 persona :

➤ Paraplegjik	20
➤ Tetraplegjia	2
➤ Paraparezë	6
➤ Asistent	17
➤ Staffi ndihmës	5



Mbështetur dhe financuar nga Onlus R. Bazzoni-Italy
Organizuar nga HandKOS

Raportin po e fillojmë me falënderimet më të përzemërta të secilit pjesëmarrës, të shprehura në fletëvlerësimet e kampit. Ky ishte kampi i 8 me radhë i cili organizohet për personat me lëndime spinale, ndërsa i 9 për të gjithë personat me aftësi të kufizuara. Në kampet e rehabilitimit aktiv kanë marrë pjesë dikun rreth 240 persona me lëndime spinale. Sot në Kosovë kemi 240 familje që për çdo mëngjes zgjohen me falënderim për ONLUS R.Bazzoni dhe organizatën HandiKOS. Sot në Kosovë kemi 240 fytyra të cilat shumë rrallë buzëqeshin, por që kampi i rehabilitimit aktiv i bëri ato të buzëqeshin shpesh dhe të jenë të gëzuara. Suksesi i jetës së çdo njeriu është ta kuptoj realitetin në të cilin gjindet në secilin moment të jetës, kampet e kanë thënë të vërtetën rreth jetës dhe njerëzit e kanë kuptuar se kthim mrapa nuk ka dhe jeta duhet të vazhdon ashtu si është.

Kampi i rehabilitimit aktiv për persona me lëndime spinale është realizuar në Ulqin, në plazhin e madh. Në kamp ishin pjesëmarrës 20 persona me paraplegji, 6 persona me paraparezë, dhe 2 persona me tetraplegji, 17 përcjellësa, 2 persona nga stafi mjekësor dhe 3 asistentë. Për dallim nga vitet tjera ky kamp u organizua i përbashkët për grupin e përzier dhe grupin e personave me lëndime spinale. Orari i aktiviteteve ishte i përbashkët dhe vendosej çdo mëngjes në hyrje të hotelit, ku qëndronin të dy grupet.

Aktivitetet e mëngjesit janë realizuar ndaras, ndërsa ato sportive janë realizua bashkërisht.

Llojet e aktiviteteve që janë realizua në kamp ishin: gjimnastika e mëngjesit, transferet (evakuimi i trupit), tejkalimi i pengesave, aktivitete sportive (shah, pikado, basketboll, ping pong, not), vozitja e veturës dhe ahengu përmbyllës ku u shpërblyen ata që dhanë rezultate më të mira gjatë kampit.

GJIMNASTIKA E MËNGJESIT

Gjimnastika e mëngjesit është realizuar çdo ditë në mëngjes prej orës 9:00 deri në 9:30 duke e zgatur orarin e aktiviteteve me tempo të ngadaltë. Aktivitetet kanë filluar gjithmonë me kohë dhe për dallim prej viteve tjera, personat të cilët kanë marrë pjesë për herë të parë në kamp kanë qenë shumë aktivë.

Si aktivitet ishte mjaft i pëlqyer dhe shumë i shëndetshëm siç potenconin personat ngjatë bisedave, ky aktivitet e fillonte secilën ditë në kamp dhe nga aty u niste e mbara për aktivitetet tjera të ditës.

Gjatë aktiviteteve të gjimnastikës janë realizuar aktivitetet e zgjatjes së muskujve dhe realizimi i lëvizjeve të muskujve të cilat shumë rrallë aplikohen nga përdoruesi i karrocës. Gjatë këtyre aktiviteteve janë realizuar edhe sllallomi, dhe tërheqja e personave me karroca.



Për çdo ditë bëhej edhe matja e shpejtësisë së kalimit të sllallomit nga personat dhe shihej përmirësim i dukshëm në zhvillimin e shpejtësisë më të madhe nga personat fillestarë.

PËRDORIMI I KARROCËS

Personat janë edukuar se si ta bëjnë bartjen e trupit nga karroca në shtrat dhe anasjelltas, po ashtu kanë marrë njohuri se si duhet ta mbajnë trupin aktiv gjatë ngasjes së karrocës. 15 pjesëmarrës në kamp ishin krejtësisht të varur nga përcjellësit e tyre për ta bartur trupin nga shtrati në karrocë dhe anasjelltas. Gjatë bisedave jemi mundu ti bindim që ata të provojnë teknikat e bartjes së trupit në mënyrë që mos të presin ndihmën vetëm nga familjarët e tyre. Ditëve në vijim ky aktivitet u zhvillua vazhdimisht dhe vetë dy apo tre persona të cilët kishin mbi peshë nuk arritën ta bëjnë këtë aktivitet vetvetiu. Gjatë këtij aktiviteti u demonstrua edhe rrëzimi nga karroca dhe si të mbrohet personi nëse i ndodh të rrëzohet nga karroca. Tejkalimi i pengesave ishte aktiviteti tjetër i cili u realizua me qëllim të përmirësimit të ngasjes së karrocës nga personat të cilët kishin lëndim të freskët. Për të qenë të sigurve se personat kanë marrë njohuri të mjaftueshme rreth ngasjes së karrocës, ne organizuam shëtitje në teren të pa përshtatshëm ku ishin pjesëmarrës të gjithë përdoruesit e karrocave. Të gjithë personat ishin të kënaqur më pas me të arriturat individuale rreth ngasjes së karrocave.



Bartja e trupit



Kalimi i pengesave

AKTIVITETET SPORTIVE

Gjatë gjithë kohës së realizimit të kampit, pjesëmarrësit kishin mundësi të realizonin lojëra të ndryshme. Atyre u janë ofruar mundësi në realizimin e lojës së shahut, ping pongut, pikado, letra etj, mirëpo në disa disiplina janë organizuar edhe gara ku janë shpërblyer më të mirët. Në grupin e personave me lëndime

spinale, më i miri në shah u zgjodh Shaban Hasani, në ping pong u zgjodh Besim Galica, në pikado Kadri Beqiri, ndërsa basketbollisti më i mirë i kapmit u zgjodh Ilmi Fazliu i cili merrte pjesë për herë të parë në kamp. Aktivitetet sportive janë përcjellë vazhdimisht nga dy koordinatorët e grupeve. Përpos garimeve lojërat kanë vazhduar vazhdimisht dhe për çdo ditë në mes të atyre që ishin rivalë dhe ishte mjaft i bukur momenti kur fitoret barazoheshin, sepse edhe më tej rritej rivaliteti.



VOZITJA E VETURËS

Nisur nga fakti që shumica e personave me lëndime spinale kanë pësuar nga aksidentet me vetura, dhe aty vërehej një dozë e frikës nga vozitja e cila shpesh edhe kalonte në ekstrem gjatë bisedave. Për ta eliminuar këtë frikë dhe për ti bërë njerëzit që prapë të ndjehen të aftë dhe të gatshëm për të zhvilluar jetë të pavarur ne e aplikuar si aktivitet të veçantë, ushtrimin e vozitjes nga personat me lëndime spinale të cilët pas aksidentit nuk kishin provua vozitjen. Ishte një ndjenjë e veçantë sa e frikshme aq e mirë për shumicën prej pjesëmarrësve të cilët veç kishin heqë dorë nga vozitja pas aksidentit. Në fletë vlerësimet e kampit, ky aktivitet është përmendur shumë herë dhe shumica e personave kanë filluar të mendojnë ndryshe për aftësinë e tyre të vozitjes. Dy persona provuan për herë të parë në jetën e tyre të vozisin dhe menjëherë pas vozitjes filluan të interesohen për pajisjen e tyre me patentë shoferi.



NOTI



Nga ora 10:00 fillonte koha e plazhit ku të gjithë personat shkonin në plazh. Asistentët ishin gjatë tërë kohës aktiv dhe ofronin gjithçka nga vetja në mënyrë që asnjë person mos të mbetet pa e provua notin. Notin e kanë provua të gjithë pjesëmarrësit, 8 prej tyre për herë të parë pas aksidentit.

Ndjenjat ishin të pa përshkrueshme në momentin kur e largonin gomën ndihmëse dhe fillonin të notonin vetë. Noti ishte aktivitet që e pëlqenin shumica e pjesëmarrësve ku edhe duke e parë njëri tjetrin të gjithë provuan atë. Gjatë qëndrimit në plazh zhvilloheshin biseda rreth jetës dhe bëheshin plane rreth së ardhmes më të mirë. Aty u krijuan shumë ura miqësie të cilat do të vazhdojnë për tërë jetën, ato ura kishin burim në ndarjen e eksperiencës personale jetësore mes njerëzve që për herë të parë takoheshin.



SEANCAT

Stafi menaxhues i kampit përpos bisedave joformale që kishte me pjesëmarrësit duke ju qasur secilit me mënyrën e tij, ka organizuar edhe tri seanca. Njëra seancë ju ka dedikuar pasojave të cilat vijnë nga lëndimi spinal dhe menaxhimit të tyre. Gjatë kësaj seance të përbashkët ku morën pjesë vetëm ata që ishin të



prekur nga këto pasoja u bisedua gjerë e gjatë duke treguar secili problemet e tij. Si konkluzion i kësaj seance ishte krijimi dhe funksionalizimi i shërbimeve adekuate për personat me lëndime spinale përmes themelimit të njësisë spinale në kuadër të QKU.

Seanca e dytë kishte të bënte me të drejtat e femrave dhe kujdesin e tyre ndaj shëndetit dhe sëmundjeve ngjitëse. Në këtë seancë

kishte rrëfime nga më të ndryshmet, aty morën pjesë edhe femrat me lëndime spinale të cilat treguan eksperiencat e tyre.

Seanca tretë formale ishte ajo për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë dhe modelet e qasjes ndaj aftësisë së kufizuar në përgjithësi. Pjesëmarrësit ishin mjaft aktiv dhe ishin të gatshëm në çdo moment të luftonin për të drejtat e tyre.

Gjatë ligjërimit u përmendën ligjet të cilat prekin aftësinë e kufizuar dhe niveli i implementimit të tyre në realitet. Të gjithë u pajtuan se këto ligje, si të tilla as për së afërmi nuk plotësojnë të drejtat sociale të personave me aftësi të kufizuara.

Duke ligjeruar për të drejtat e njeriut



SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Stafi shëndetësorë i përbërë nga një mjek dhe dy teknike medicinale kanë qenë vazhdimisht me pjesëmarrësit, që nga koha e zgjimit deri kur binin në shtrat. Nuk ka pasur nevojë për intervenime serioze që kanë kërkuar trajtim specifik nga specialisti, mirëpo të gjitha kanë qenë sipërfaqësore. Si pasojë e ndërrimit të ushqimit kanë pasur problem me adoptim dhe kanë vuajtur nga diarreja disa persona, 3 prej tyre janë trajtuar me infuzion. Si pasojë e infeksioneve urinare dhe problemeve tjera jo shumë serioze 3 persona janë trajtuar me ampula, 5 persona kanë pësua lëndime të lehta gjatë transferimeve, dhe këto lëndime janë eliminuar shumë shpejt. Ndërsa si pasojë e qëndrimit të gjatë në diell 5 persona kanë pësua djegie të lehta, të cilët më pas janë trajtuar nga stafi shëndetësor. Tre persona të cilët kanë përdorë kateter të përhershëm për një kohë të gjatë janë edukuar që ato ti eliminojnë dhe të fillojnë përdorimin e kateterave të përkohshëm, dy prej tyre e kanë aplikuar këtë menjëherë.



SUKSESET INDIVIDUALE (Ribashkimi)

Në këtë kamp ishin pjesëmarrës një qift bashkëshortor nga Deqani të cilët deri në momentin e fundit nuk ishin të sigurt nëse do të merrnin pjesë në kamp. Pas disa bisedave që stafi i kampit kishte me këtë qift, respektivisht me bashkëshortin i cili ishte person me lëndim spinal e bindëm që ai të merr pjesë në kamp. Edhe pse vendosi të marr pjesë në kamp nuk ishte i sigurt nëse do të vinte me bashkëshorte apo do ta merrte dikë tjetër si përcjellës.

Pasi që vendosën të dy të jenë bashkë në kamp, ne si staf filluam të interesohemi se pse ka qenë gjithë ajo dilemë për ta marrë bashkëshorten në kamp. Pas disa bisedave ne kuptuam se pasi që ky person kishte pësuar lëndim, ky qift bashkëshortor nuk kishte kaluar asnjë natë të vetme së bashku. E tëra kjo kishte ndodhur si pasojë e mendimeve negative të prindërve të tij, rreth kujdesit të mjaftueshëm nga bashkëshortja e tij.

Ata i vendosëm në një dhomë me një krevat, në katin e parë të hotelit. Pas këshillave tona rreth bartjes së trupit dhe lëvizjes me karrocë ky person u bë shumë i pavarur dhe si për habi tonën u bë qifti më i lumtur dhe më simpatik i kampit. Pas gjitha këtyre të arriturave ai ishte i interesuar se si ta eliminoj përdorimin e materialit të inkontinencës të cilin e përdorte edhe tani. Ne filluam ta këshillojmë atë, i dhamë këshillat dhe medikamentet e nevojshme të cilat i blemë nga buxheti i kampit. Ai i mori këto këshilla shumë seriozisht dhe filloi ta aplikoj metodën e re të autokateterizimit.

Një mbrëmje vendosëm të organizojmë party dhe si pjesë e këtij party të jetë edhe shpërndarja e shpërblimeve për më të mirët në fusha sportive dhe sociale. Ky qift u zgjodh qifti më simpatik i kampit dhe u shpërblye me një dhuratë modeste. Ata premtuan se këtë dhuratë do ta ruajnë si shenjë e ribashkimit të tyre.

Tani jemi kthyer në Kosovë dhe ky qift vazhdimisht na thërret në telefon dhe na ka ftuar që të jemi mysafir në shtëpinë e tyre.



Çifti më sharmant